

L I G J
Nr.7899, datë 2.2.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7788, DATË 9.2.1994 DHE LIGJIN NR.7852, DATË 29.7.1994

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7788, datë 9.2.1994, dhe ligjin nr.7852, datë 29.7.1994, në nenin 7, në kapitullin “Për taksat nacionale”, pika “a” ndryshohet si vijon:

“a) Anijet, të cilat kryejnë veprime tregtare, sa herë që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë, paguajnë taksa portuale sipas lidhjes nr.1 që i bashkëngjitet këtij ligji.

Veprime tregtare të anijeve quhen ngarkimi ose shkarkimi i mallrave, zbarkimi dhe imbarkimi i udhëtarëve për transport.

Nuk quhen veprime tregtare:

- Riparimi ose dokimi i anijes.
- Zbarkimi i personave të transportuar nga anija, që ndiqen nga autoritetet përkatëse ligjore.
- Zbarkimi ose imbarkimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve dhe personave të sëmurë.
- Ngarkimi ose shkarkimi i mallrave të përfaqësive të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë dhe të përfaqësive tona diplomatike jashtë vendit.

- Furnizimi i anijeve me ujë të pijshëm, sende ushqimore, karburante e lubrifikante, materiale e pjesë ndërrimi etj.

- Ndalesat në porte të anijeve për shkak të kohës së keqe, avarive të ndryshme dhe veprimeve në ndihmë të tyre nga anijet e tjera.

- Hyrja në porte pa ngarkesë të anijeve të personave fizikë e juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Në nenin 8, kapitulli A “Për taksat nacionale” pika “a” ndryshohet si më poshtë:

a) Për taksat portuale 2 për qind

Nga e cila:

- Kapitenerisë së porteve 2 për qind

Neni 3

Në nenin 9 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“a) Përjashtohen nga pagimi i taksave portuale:

- Anijet që transportojnë ndihma humanitare në Republikën e Shqipërisë.
- Anijet e shërbimeve detare në porte.

Anijet luftarake, spitalore, kabëllmbajtëse, si dhe anijet bazë dhe ato që u shërbejnë atyre për zonat e kërkimit e të shfrytëzimit të naftës në det.

b) Për anijet që prekin portin e Durrësit, taksat portuale zbatohen në masën 100 për qind, kurse për anijet që prekin portet e Vlorës, Sarandës, Shëngjinit dhe pikën e bezinsjellësit në Vlorë, taksat portuale zbatohen në masën 20 për qind më të ulëta.

c) Për anijet e personave fizikë dhe juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë taksat portuale zbatohen:

- me 50 për qind zbritje për anijet me flamur shqiptar;
- me 20 për qind zbritje për anijet me flamur të huaj

ç) Anijet me flamur shqiptar të personave fizikë a juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë që kryejnë transport të brendshëm detar dhe të peshkimit, paguajnë taksën e anijes një herë në preken e parë të çdo porti shqiptar dhe nuk paguajnë në hyrjet pasuese gjatë vitit kalendarik”.

Neni 4

Ligji nr.7852, datë 29.7.1994 “Për një shtesë në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet. Lidhja nr.1 së bashku me shënimin poshtë saj e ligjit nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7788, datë 9.2.1994, shfuqizohet dhe zëvendësohet me lidhjen nr.1 “Taksat portuale” që i bashkëngjitet këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1021, datë 14.2.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

LIDHJA NR.1

NIVELI I TAKSAVE PORTUALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në dollarë USA

Për çdo ton neto
regjistër të anijeve

Gjithsej për
çdo anije

TAKSA PORTUALE

1. Taksë e anijes

a) Për anijet që ngarkojnë
dhe shkarkojnë mallra të përgjithshme 0,4

b) Për anijet që ngarkojnë dhe shkarkojnë
mallra të lëngshme 0,6

c) Për anijet traget, RO/RO dhe të udhëtarëve 0,35

d) Për anijet sportive, jahte

- Deri në 30 TNR 15

- Nga 31 deri 70 TNR 30

2. Taksa feneri

- Për anije deri në 500 TNR 20

- Për anije mbi 501 TNR 50

3. Taksa për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, kapitenerisë së porteve dhe auto- ritetet e tjera:

- Për anije deri në 500 TNR 100

- Për anije nga 501 deri 2000 TNR 180

- Për anije nga 2001 deri 4000 TNR 210

4. Anijet që ngarkojnë ujë për eksport në pikat jashtë porteve, paguajnë taksa portuale gjithsej në masën 300 dollarë amerikanë për çdo rast furnizimi.

5. Anijet e huaja i paguajnë taksat portuale në valutë lirisht të kovertueshme, kurse anijet e personave juridikë a fizikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë paguajnë në valutë ose në lekë në raport me realizimin e të ardhurave.

6. Taksa portuale paguhen në prekjen e parë të çdo porti shqiptar, pavarësisht se anija do të shkojë për veprime tregtare dhe në porte të tjera shqiptare në të njëjtin rejs.